LIGJ
Nr. 24/2016

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERATIVE TË BRAZILIT PËR SHËRBIMET AJRORE

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federative të Brazilit për shërbimet ajrore.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 10.3.2016

Shpallur me dekretin nr. 9476, datë 24.3.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERATIVE TË BRAZILIT MBI SHËRBIMET AJRORE

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë (Shqipëria) dhe Qeveria e Republikës Federative të Brazilit (Brazili) të referuara më poshtë si "Palët";

duke qenë palë në Konventën mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar, të hapur për nënshkrim në Çikago, në datën 7 dhjetor 1944;

duke dëshiruar të kontribuojnë në progresin e aviacionit civil ndërkombëtar;

duke dëshiruar të lidhin një marrëveshje me qëllim krijimin dhe operimin e shërbimeve ajrore ndërmjet dhe përtej territoreve të tyre përkatës,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj marrëveshje, përveç rasteve kur është deklaruar ndryshe, termi:

a) "autoriteti aeronautik" nënkupton, në rastin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Ministrin e Punëve Publike dhe Transportit, në personin e Autoritetit të Aviacionit Civil; në rastin e Republikës Federative të Brazilit, autoritetin e aviacionit civil të përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Aviacionit Civil (AKAC), ose në të dyja rastet çdo autoritet apo person tjetër i autorizuar për kryerjen e funksioneve të ushtruara nga autoritetet e përmendura;

b) "Marrëveshje" nënkupton këtë Marrëveshje, çdo shtojcë e saj, dhe çdo amendament i saj;

c) "kapacitet" nënkupton sasinë/sasitë e shërbimeve të parashikuara në këtë Marrëveshje, të matura zakonisht me numrin e fluturimeve (frekuencave) ose vendeve apo toneve të ngarkesave të ofruara në një treg (qyet me qytet, ose shtet me shtet) ose në një linjë për një periudhë të veçantë, si ditore, javore, sezonale ose vjetore;

d) "Konventa" nënkupton Konventën mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar e hapur për

nënshkrim në Çikago në datën 7 dhjetor 1944, dhe përfshin çdo shtojcë të miratuar sipas nenit 90 të kësaj Konvente, dhe çdo amendament të Shtojcave apo Konventës sipas neneve 90 dhe 94, për aq sa këto shtojca dhe amendamente kanë hyrë në fuqi për të dyja Palët;

e) "linja ajrore e përcaktuar" nënkupton një linjë ajrore e cila është përcaktuar dhe autorizuar në përputhje me nenin 3 ("Përcaktimi dhe autorizimi") të kësaj Marrëveshje;

f) "çmimi" nënkupton çdo tarifë, normë apo pagesë, për transportimin e pasagjerëve, bagazheve dhe/ose ngarkesave, duke përjashtuar postën, në transportin ajror, duke përfshirë çdo mënyrë tjetër transportimi në lidhje me këtë, të vendosura nga linjat ajrore, si dhe duke përfshirë agjentët e tyre dhe kushtet që rregullojnë vlefshmërinë e këtyre tarifave, normave apo pagesave;

g) "territori" në lidhje me një shtet ka kuptimin që i është caktuar asaj në nenin 2 të Konventës;

h) "Pagesa e përdoruesit" është një pagesë për linjat ajrore nga autoritetet kompetente, ose e lejuar prej tyre për t'u bërë, për sigurimin e pronës ose mjediseve në aeroport, pajisjeve të navigacionit ajror, ose pajisjeve apo shërbimeve të sigurisë së aviacionit, duke përfshirë shërbimet dhe pajisjet përkatëse, për avionë, ekuipazhin e tyre, pasagjerët dhe ngarkesat; dhe

i) "shërbimi ajror", "shërbimi ndërkombëtar ajror", "linjë ajrore" dhe "ndalesë për qëllime jo trafiku" kanë kuptimet e përcaktuara në nenin 96 të Konventës.

Neni 2

Dhënia e të drejtave

1. Secila Palë i jep Palës tjetër të drejtat e specifikuara në këtë Marrëveshje me qëllim operimin e shërbimeve ajrore ndërkombëtare në itineraret e specifikuara në Programin e Itinerareve, i miratuar bashkërisht nga autoritetet aeronautike të të dyja Palëve.

2. Sipas dispozitave të kësaj Marrëveshje, linja/t ajrore të përcaktuara nga secila Palë, do të gëzojnë këto të drejta:

a) të fluturojnë pa ulje përmes territorit të Palës tjetër;

b) të bëjnë ndalesa në territorin e Palës tjetër për qëllime jo trafiku;

c) të bëjë ndalesa në pikën/pikat e itinerarit /itinerareve të specifikuara në Programin e Itinerareve të miratuar bashkërisht nga autoritetet aeronautike të të dyja Palëve me qëllim marrjen në bord dhe shkarkimin e trafikut ndërkombëtar të pasagjerëve, bagazheve, ngarkesave apo postës në mënyrë të ndarë ose të kombinuar; dhe

d) të drejta të tjera të specifikuara në këtë Marrëveshje.

3. Linjat ajrore të secilës Palë, përveç atyre të përcaktuara sipas nenit 3 ("Përcaktimi dhe autorizimi") të kësaj Marrëveshje do të gëzojnë, gjithashtu, edhe të drejtat e specifikuara në paragrafët 2/"a" dhe "b" të këtij neni.

4. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të konsiderohet se i jep linjës/linjave ajrore të përcaktuara të njërës Palë privilegjin e marrjes në bord, në territorin e Palës tjetër, pasagjerë, bagazhe, ngarkesë apo postë, për shpërblim dhe të destinuar për një pikë tjetër në territorin e Palës tjetër.

Neni 3

Përcaktimi dhe autorizimi

1. Secila Palë do ketë të drejtë t'i përcaktojë me shkrim Palës tjetër, një ose më shumë linja ajrore për të operuar shërbimet e miratuara dhe të tërheqë ose ndryshojë këto përcaktime nëpërmjet kanaleve diplomatike.

2. Me marrjen e një përcaktimi të tillë dhe aplikimi nga linja ajrore e përcaktuar, në formën dhe mënyrën e përshkruar për autorizimin e operimit, secila Palë duhet të japë autorizimin e përshtatshëm operues me vonesën minimale procedurale, me kusht që:

a) Linja ajrore e përcaktuar të jetë e vendosur në territorin e Palës përcaktuese;

b) Kontrolli efektiv rregullator i linjës ajrore të përcaktuar të ushtrohet dhe të mirëmbahet nga Pala që përcakton linjën ajrore;

c) Pala përcaktuese e linjës ajrore të jetë në përputhje më dispozitat e vendosura në nenin 7 ("Siguria") dhe neni 8 ("Sigurimi i Aviacionit"); dhe

d) Linja ajrore e përcaktuar të jetë e kualifikuar për të plotësuar kushte të tjera të parashikuara sipas ligjeve dhe rregullave të cilat aplikohen normalisht për operimin e shërbimeve të transportit ajror ndërkombëtar nga Pala e cila merr përcaktimin.

3. Me marrjen e autorizimit të operimit sipas paragrafit 2, një linjë ajrore e përcaktuar mund, në çdo kohë, të fillojë të operojë shërbimet e miratuara për të cilat ajo është përcaktuar, me kusht që linja ajrore të përmbushë dispozitat e zbatueshme të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

Ndërprerja, tërheqja dhe kufizimi i autorizimit

1. Autoritetet aeronautike të secilës Palë do të kenë të drejtën të ndërpresin autorizimet e përmendura në nenin 3 ("Përcaktimi dhe autorizimi") të kësaj Marrëveshje të cilat i përkasin një linje ajrore të përcaktuar nga Pala tjetër, dhe të tërheqin, pezullojnë apo të vendosin kushte të përkohshme apo të përhershme mbi autorizime të tilla në rast se:

a) Ata janë të pakënaqur që linja ajrore e përcaktuar është e vendosur në territorin e Palës që ka përcaktuar linjën ajrore; ose

b) Kontrolli efektiv rregullues i linjës ajrore të përcaktuar nuk ushtrohet dhe mbahet nga Pala që ka bërë përcaktimin e linjës ajrore; ose

c) Pala që ka bërë përcaktimin e linjës ajrore dështon të përmbushë dispozitat e parashtruara në nenin 7 ("Siguria") dhe neni 8 ("Sigurimi i Aviacionit"); ose

d) Linja ajrore e përcaktuar nuk është e kualifikuar për të plotësuar kushte të tjera të parashikuara sipas ligjeve dhe rregullave të cilat aplikohen normalisht për operimin e shërbimeve të transportit ajror ndërkombëtar nga Pala e cila merr përcaktimin.

2. Përveç rastit kur tërheqja, pezullimi apo vendosja e kushteve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni është thelbësor për të parandaluar shkelje të mëtejshme të ligjeve dhe rregullave, ose të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, një e drejtë e tillë do të ushtrohet vetëm pas konsultimit me Palën tjetër. Konsultime të tilla duhet të zhvillohen përpara mbarimit të afatit 30 (tridhjetë) ditor në vijim të kërkesës nga njëra Palë, përveç rasteve ku Palët bien dakord ndryshe.

Neni 5

Zbatimi i ligjit

1. Ligjet dhe rregullat e një Pale në lidhje me hyrjet dhe nisjet nga territori i saj, të avionëve të angazhuar me shërbimet ndërkombëtare ajrore, ose operimi apo navigacioni i avionëve të tillë brenda territorit të saj, do të aplikohet edhe për avionët e linjave ajrore të Palës tjetër.

2. Ligjet dhe rregullat e një Pale që lidhen me hyrjen, qëndrimin dhe nisjen nga territori i saj i pasagjerëve, bagazheve, ekuipazhit dhe ngarkesave duke përfshirë postën si ato që lidhen me emigrimin, doganat, monedhën si dhe shëndetin dhe karantinën, do të aplikohen mbi pasagjerët, ekuipazhin , ngarkesën dhe postën e mbajtur nga avioni i linjës ajrore të Palës tjetër, ndërkohë që janë brenda territorit në fjalë.

3. Asnjëra nga Palët nuk duhet t'i japë prioritet linjës ajrore të saj ose çdo linje ajrore tjetër kundrejt një linje ajrore të Palës tjetër të angazhuar në transportim të ngjashëm ajror ndërkombëtar në zbatim të rregullave të tij të emigrimit, doganave, karantinës e të tjera të ngjashme.

4. Pasagjerët, bagazhet, ngarkesa dhe posta në transit direkt do të jenë subjekt i jo më shumë se një kontrolli të thjeshtëzuar. Bagazhet dhe ngarkesat në transitin direkt do të përjashtohen nga taksat doganore dhe taksa të tjera të ngjashme.

Neni 6

Njohja e certifikatave dhe licencave

1. Certifikatat mbi gatishmërinë për fluturim, certifikatat e kompetencave dhe licencat e lëshuara apo të bëra të vlefshme nga një Palë dhe që janë ende në fuqi, do të njihen si të vlefshme nga Pala tjetër me qëllimin e operimit të shërbimeve të miratuara, me kusht që kërkesat sipas të cilave këto certifikata dhe licenca janë lëshuar apo bërë të vlefshme të jenë të barabarta ose mbi standardet

minimale të cilat mund të jenë të vendosura sipas Konventës.

2. Nëse privilegjet apo kushtet e licencave apo certifikatave referuar në paragrafin 1 më lart, të lëshuara nga autoritetet aeronautike të një Pale për një person ose një linjë ajrore të përcaktuar ose në lidhje me një avion të përdorur për operimin e shërbimeve të miratuara, lejojnë një ndryshim nga standardet minimale të vendosura sipas Konventës, ndryshim i cili është regjistruar nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ONAC), Pala tjetër mund të kërkojë konsultime midis autoriteteve aeronautike më qellim sqarimin e praktikës në fjalë.

3. Megjithatë, secila palë ka të drejtën të refuzojë njohjen e certifikatave të kompetencave dhe licencave të dhëna shtetasve të saj nga Pala tjetër me qëllimin e fluturimeve mbi dhe uljen brenda territorit të saj.

Neni 7

Siguria

1. Secila Palë mund të kërkojë konsultime në çdo kohë në lidhje me standardet e sigurisë të mbajtura nga Pala tjetër në fushat që lidhen me pajisjet aeronautike, ekuipazhit të fluturimit, avionëve dhe operimit të avionëve. Konsultime të tilla duhet të zhvillohen brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga paraqitja e kërkesës.

2. Nëse, pas këtyre konsultimeve, njëra Palë zbulon se Pala tjetër nuk ka mbajtur dhe administruar në mënyrë efektive standardet e sigurisë në fushat e referuara në paragrafin 1, të cilat përmbushin standardet e vendosura në atë kohë sipas Konventës, Pala tjetër duhet të informohet për këto zbulime dhe për hapat e vlerësuara të nevojshme për të përmbushur standardet e ONAC-ut. Pala tjetër duhet më pas të ndërmarrë veprime korrektuese të përshtatshme brenda një periudhe të miratuar kohore.

3. Sipas nenit 16 të Konventës, është miratuar më tej se, çdo avion i operuar nga apo në emër të një linje ajrore të njërës Palë, për shërbimin në ose nga territori i një Pale tjetër, ndërkohë që është në territorin e Palës tjetër mund të jetë subjekt i një kërkimi nga përfaqësuesit e autorizuar të Palës tjetër, me kusht që kjo të mos shkaktojë vonesa në operimin e avionit. Pavarësisht detyrimeve të përmendura në nenin 33 të Konventës, qëllimi i këtij kërkimi është të verifikojë vlefshmërinë e dokumentacionit të avionit në fjalë, licencimin e ekuipazhit të tij, si dhe nëse pajisjet dhe kushtet e avionit janë konform standardeve të vendosura në atë kohë sipas Konventës.

4. Në rastin kur veprime urgjente janë thelbësore për sigurinë e operimit të një linje ajrore, secila Palë ka të drejtë të pezullojë apo të ndryshojë menjëherë autorizimin operues të një apo më shumë linjave ajrore të Palës tjetër.

5. Çdo veprim i një Pale në përputhje me paragrafin 4 më lart, do të ndërpritet në momentin kur pushon së ekzistuari baza e ndërmarrjes së këtij veprimi.

6. Në referencë të paragrafit 2, nëse është përcaktuar se një Palë vazhdon të jetë në mospërputhje me standardet e ONAC-ut kur periudha kohore e miratuar ka kaluar, Sekretari i Përgjithshëm i ONAC-ut duhet të njoftohet për këtë. Ky i fundit duhet të njoftohet edhe për zgjidhjet pasuese të kënaqshme të situatës.

Neni 8

Sigurimi i Aviacionit

1. Në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre sipas ligjit ndërkombëtar, Palët riafirmojnë se detyrimi i tyre ndaj njëri-tjetrit për të mbrojtur sigurinë e aviacionit civil ndaj akteve të ndërhyrjeve të paligjshme formon një pjesë integrale të kësaj Marrëveshje. Pa kufizuar përgjithshmërinë e të drejtave dhe detyrimeve të tyre sipas ligjit ndërkombëtar, Palët do të veprojnë veçanërisht konform dispozitave të Konventës mbi Kundërvajtjet dhe akte të tjera të caktuara të Kryera në Bord të Avionëve, nënshkruar në Tokio, në datën 14 shtator 1963, të Konventës për Shtypjen e Konfiskimit të Paligjshëm të Avionit nënshkruar në Hagë, në datën 16 dhjetor 1790 dhe të Konventës për Shtypjen e Veprimeve të Paligjshme kundër Sigurisë së Aviacionit Civil, nënshkruar në Montreal, në datën 23 shtator 1971, Protokolli i tij Plotësues për Shtypjen e Akteve të Paligjshëm të Dhunës në

Aeroporte në Shërbim të Aviacionit Civil Ndërkombëtar, nënshkruar në Montreal, më 24 shkurt 1988, Konventës për Shënjimin e Eksplozivëve Plastikë me Qëllim Zbulimin, nënshkruar në Montreal, më 1 mars 1991, si dhe në përputhje me çdo konventë apo protokoll tjetër në lidhje më sigurinë e aviacionit civil në të cilën të dyja Palët aderojnë.

2. Palët do t'i sigurojnë me anë të kërkesës gjithë ndihmën e nevojshme njëra tjetrës, për të parandaluar aktet e konfiskimit të paligjshëm të avionëve civil dhe akte të tjera të paligjshme kundër sigurisë së këtyre avionëve, pasagjerëve dhe ekuipazhit të tyre, aeroporteve dhe pajisjeve naviguese, dhe çdo kërcenim tjetër ndaj sigurisë së aviacionit civil.

3. Palët, në marrëdhëniet e tyre të përbashkëta, do të veprojnë konform dispozitave të sigurisë së aviacionit të vendosura nga ONAC-u dhe të përcaktuara si Shtojca të Konventës; ata duhet të kërkojnë që operatorët e avionëve të regjistrit të tyre ose operatorët e avionëve të cilët janë të vendosur në territorin e tyre dhe operatorët e aeroporteve në territorin e tyre të veprojnë konform dispozitave të tilla mbi sigurinë e aviacionit. Secila Palë do të njoftojë Palën tjetër për çdo ndryshim midis rregullave dhe praktikave të saj kombëtare dhe standardeve të sigurisë së aviacionit të Shtojcave. Secila Palë mund të kërkojë konsultime të menjëhershme me Palën tjetër në çdo kohë për të diskutuar këto ndryshime.

4. Secila Palë bie dakord që operatorëve të tillë të avionëve mund t'u kërkohet të respektojnë dispozitat e sigurisë së aviacionit të referuar në paragrafin 3 më lart, të kërkuar nga Pala tjetër për hyrjen, nisjen, ose ndërsa janë brenda territorit të asaj Pale tjetër. Secila Palë duhet të sigurohet se masat e duhura janë zbatuar efektivisht brenda territorit të saj për të mbrojtur avionin dhe për të inspektuar pasagjerët, ekuipazhin, artikujt e dorës, bagazhin, ngarkesën dhe depozitat e avionit përpara dhe gjatë hipjes apo ngarkimit. Secila Palë do të marrë, gjithashtu, në konsideratë me dashamirësi çdo kërkese nga Pala tjetër për masa të veçanta të arsyeshme të sigurisë për të përballuar një kërcënim të caktuar.

5. Kur ndodh një incident ose kërcenim i një incidenti për konfiskim të paligjshëm të avionit civil apo akte të tjera të paligjshme kundër sigurisë së këtyre avionëve, pasagjerëve dhe ekuipazhit të tyre, aeroportit apo pajisjeve të navigacionit ajror, Palët do të asistojnë njëra-tjetrën duke lehtësuar komunikimin dhe masat e tjera të përshtatshme të synuara për përfundimin me shpejtësi dhe siguri të këtyre incidenteve apo kërcënimeve.

6. Çdo Palë do të ketë të drejtë, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve që nga njoftimi, që autoriteti i tij aeronautik të kryejë në territorin e Palës tjetër një vlerësim rreth masave të sigurisë që kryhen, ose planifikohen të kryhen nga operatorët e avionëve për sa i përket fluturimeve që vijnë nga apo nisen për në territorin e Palës së parë. Rregullimet administrative për kryerjen e vlerësimeve të tilla do të miratohen ndërmjet autoriteteve aeronautike dhe do të zbatohen pa vonesa për t'u siguruar se vlerësimet do të kryhen shpejt.

7. Kur një Palë ka arsye të pranueshme për të besuar se Pala tjetër është shmangur nga dispozitat e këtij neni, ajo mund të kërkojë konsultime. Këto konsultime do të fillojnë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve që nga marrja e kërkesës nga secila Palë. Mosarritja e një marrëveshjeje të kënaqshme brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga fillimi i konsultimeve përbën arsye për tërheqje, revokime, pezullime ose vendosje kushtesh mbi autorizimet e linjës/linjave ajrore të përcaktuara nga Pala tjetër. Kur është e justifikuar nga një emergjencë, apo për të parandaluar mospërputhje të tjera me dispozitat e këtij neni, Pala e parë mund të ndërmarrë veprime të përkohshme në çdo kohë.

Neni 9

Pagesa e përdoruesit

1. Asnjë nga Palët nuk do të vendosë apo do të lejojë të vendosen mbi linjat ajrore të përcaktuara të Palës tjetër, pagesa të përdoruesit më të larta se ato të vendosura ndaj linjave të veta ajrore që operojnë shërbime ndërkombëtare të ngjashme.

2. Secila Palë do të nxisë konsultimet mbi pagesat e përdoruesit ndërmjet autoritetit të tij kompetent që kërkon pagesën dhe linjave ajrore që përdorin shërbimet dhe pajisjet e ofruara, aty ku është e mundur përmes atyre organizatave përfaqësuese të linjave ajrore. Për çdo propozim për

ndryshime në pagesat e përdoruesit, këtyre përdoruesve duhet t'u bëhen njoftime të arsyeshme për t'u mundësuar atyre të shprehin pikëpamjet e tyre përpara se të bëhen ndryshimet. Secila Palë do të nxisë më tej autoritetin e tij kompetent që kërkon pagesën dhe këta përdorues të shkëmbejnë informacione të përshtatshme në lidhje më pagesat e përdoruesit.

Neni 10

Detyrimet doganore

1. Avioni i shoqërisë ajrore të një Pale Kontraktuese që operon shërbime ndërkombëtare si dhe furnizimet e karburantit, vajrave lubrifikues, furnizime të tjera të ngjashme teknike të konsumueshme, pjesë këmbimi, pajisje të rregullta dhe rezervat e mbajtura në bord, me mbërritjen ose largimin nga territori i Palës tjetër Kontraktuese, përjashtohen mbi bazën e reciprocitetit nga detyrimet e importit përfshirë këtu tarifën doganore, akcizën, TVSH, taksa dhe tatime të tjera që paguhen në import, tarifa e inspektimit dhe detyrime të tjera të ngjashme, me kusht që pajisjet dhe furnizime të tilla të mbahen në bord të avionit deri në një kohë që ato të rieksportohen ose të përdoren apo konsumohen nga një avion i tillë, në fluturimet mbi atë territor.

2. Përjashtimet e dhëna nga ky nen do të aplikohen mbi artikujt e përmendura në paragrafin 1:

a) të paraqitura në territorin e Palës nga ose në emër të linjës ajrore të përcaktuar të Palës tjetër;

b) të mbajtura në bord të avionit të linjës ajrore të përcaktuar të njërës Palë pas mbërritjes dhe largimit nga territori i Palës tjetër; ose

c) të marra në bord të avionit të linjës ajrore të përcaktuar të njërës Palë në territorin e Palës tjetër dhe të synuar për përdorim në operimin e shërbimeve të miratuara.

Edhe nëse këto artikuj janë plotësisht të përdorura apo të konsumuara ose jo brenda territorit të Palës që jep përjashtimet, me kusht që pronësia mbi këto artikuj të mos i transferohet Palës në fjalë.

3. Pajisjet e rregullta në fluturim, si dhe materialet dhe pajisjet e mbajtura normalisht në bord të avionit të një linje ajrore të përcaktuar të secilës Palë, mund të shkarkohen në territorin e Palës tjetër vetëm me miratimin e autoriteteve doganore të atij territori. Në raste të tilla, ato mund të vendosen nën mbikëqyrjen e autoriteteve në fjalë për aq kohë sa ato rieksportohen ose ndryshe asgjësohen në përputhje më rregullat doganore.

4. Përjashtimet jepen, gjithashtu, nga detyrimet e importit përfshirë këtu tarifën doganore, akcizën, TVSH-në, taksa dhe tatime të tjera që paguhen në import, mbi bazën e reciprocitetit për materialet e printuara të biletave, faturat shoqëruese të mallit, çdo material të printuar i cili mban simbolin e kompanisë dhe materialin e zakonshëm reklamues të shpërndarë falas nga linja ajrore e përcaktuar vetëm në lidhje me shërbimin e avionit të linjës ajrore.

Neni 11

Tatimet

1. Kapitali i paraqitur i avionit, i operuar në shërbime ndërkombëtare ajrore nga një linjë ajrore e përcaktuar do të jetë i tatueshëm vetëm në territorin e Palës në të cilën ndodhet vendi i menaxhimit efektiv të linjës ajrore.

2. Përfitimet nga operimi i avionit të linjës ajrore të përcaktuar në shërbimet ndërkombëtare ajrore si dhe të mallrat dhe shërbimet që i jepen atij do të jenë të tatueshme sipas ligjit të secilës Palë.

Neni 12

Kapaciteti

1. Secila Palë duhet t'i lejojë çdo linje ajrore të përcaktuar të vendosë frekuencën dhe kapacitetin e transportit ajror ndërkombëtar që ajo ofron bazuar në vlerësimet komerciale të tregut.

2. Asnjëra nga Palët nuk do të kufizojë në mënyrë të njëanshme volumin e trafikut, frekuencën apo rregullsinë e shërbimit, ose llojin/llojet e avionëve që operohen nga linjat ajrore të përcaktuara të Palës tjetër, përveç rasteve kur kjo mund të kërkohet për arsye doganore, teknike, operative ose

mjedisore sipas kushteve unike në përputhje me nenin 15 të Konventës.

Neni 13
Çmimi

1. Çmimet e vendosura për shërbimet ajrore të operuara sipas kësaj Marrëveshje mund të vendosen lirisht nga linjat ajrore dhe nuk do të jenë subjekt i miratimit.

2. Secila Palë mund të kërkojë nga autoritetet e linjës ajrore të përcaktuar njoftimin ose regjistrimin e çmimeve të transportimit me origjinë nga territori i tij.

Neni 14
Konkurrenca

1. Palët do të informojnë njëra tjetrën rreth ligjeve, politikave dhe praktikave të tyre të konkurrencës apo për ndryshime në to, dhe çdo objektiv të veçantë, të cilat mund të ndikojnë në operimin e shërbimeve të transportit ajror sipas kësaj marrëveshje dhe do të identifikojnë autoritetet përgjegjëse për implementimin e tyre.

2. Palët do të njoftojnë njëra tjetrën kurdo që konsiderojnë se mund të ketë papërputhshmëri ndërmjet zbatimit të ligjit, politikave dhe praktikave të tyre të konkurrencës dhe çështjet që lidhen me funksionimin e kësaj Marrëveshje.

3. Pavarësisht nga ndonjë dispozitë në kundërshtim, asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të: i) kërkojë apo favorizojë miratimin e marrëveshjeve midis sipërmarrjeve, vendimet nga shoqëritë e sipërmarrjeve ose praktikat e bashkërenditura që parandalojnë apo çrregullojnë konkurrencën; ii) përforcojë efektet e marrëveshjeve, vendimeve apo praktikave të bashkërenditura të tilla; ose iii) delegojë operatorëve privatë ekonomik përgjegjësinë për marrjen e masave që para-ndalojnë, çrregullojnë apo kufizojnë konkurrencën.

Neni 15
Konvertimi i valutave dhe dërgimi i fitimeve

1. Secila Palë do t'i lejojë linjës/linjave ajrore të Palës tjetër të konvertojnë apo të transmetojnë jashtë shtetit, me kërkesë, të gjitha të ardhurat lokale nga shitja e shërbimeve të transportit ajror dhe nga aktivitetet përkatëse të lidhura direkt me transportin ajror, që janë më të mëdha se shumat e disbursuara në nivel lokal, me konvertim dhe dërgim të lejuar menjëherë, në kursin e zbatueshëm të shkëmbimit që nga data e kërkesës për konvertim dhe dërgim.

2. Konvertimi dhe dërgimi i të ardhurave të tilla do të lejohet konform ligjeve dhe rregullave të zbatueshme dhe nuk janë subjekt i ndonjë detyrimi shkëmbimi apo administrativ përveç atyre që kryhen normalisht nga bankat për realizimin e këtij konvertimi dhe dërgimi.

3. Dispozitat e këtij neni nuk përjashtojnë linjat ajrore të të dyja Palëve nga detyrimet, taksat dhe kontributet ndaj të cilave ato janë subjekt.

4. Nëse ka një marrëveshje të veçantë midis Palëve për të evituar tatimin e dyfishtë, ose një marrëveshje të veçantë e cila rregullon transferimin e fondeve midis Palëve, këto marrëveshje do të mbizotërojnë.

Neni 16
Aktivitetet tregtare

1. Secila Palë do t'i akordojë Palës tjetër të drejtën të shesë dhe tregtojë shërbime ajrore ndërkombëtare në territorin e saj në mënyre direkte ose përmes agjentëve apo ndërmjetësve të tjerë të zgjedhur nga linja ajrore, duke përfshirë këtu të drejtën për të vendosur zyra, si zyra në linjë ashtu

edhe jashtë linjës.

2. Çdo linjë ajrore do të ketë të drejtën të shesë transportin në monedhën e atij territori ose sipas ligjeve dhe rregullave të tij kombëtare, në monedha lirisht të konvertueshme të shteteve të tjera, dhe çdo person do të jetë i lirë të blejë këtë transport në monedhat e pranuara nga linja ajrore.

3. Linja/linjat ajrore të përcaktuara të një Pale do të lejohen, në bazë të reciprocitetit, të sjellin dhe të mbajnë në territorin e Palës tjetër stafin e tyre përfaqësues dhe tregtar, operative dhe teknik, siç kërkohet në lidhje me operimin e shërbimeve të miratuara.

4. Këto kërkesa të stafit mund, sipas opsionit të linjës/linjave ajrore të përcaktuara të një Pale, të plotësohen nga personeli i tyre ose duke përdorur shërbimet e çdo organizate, kompanie apo linje ajrore operuese tjetër në territorin e Palës tjetër dhe autorizohen të kryejnë shërbime të tilla për linjat e tjera ajrore.

5. Përfaqësuesit dhe stafi do të jenë subjekt i ligjeve dhe rregullave që janë në fuqi në Palën tjetër, dhe në përputhje më këto ligje dhe rregulla:

a) Çdo Pale, në bazë të reciprocitetit dhe me vonesën minimale, do t'i japë përfaqësuesve dhe stafit të referuar në paragrafin 3 të këtij neni, autorizimet e nevojshme për punësim, vizat për vizitor dhe dokumente të tjera të ngjashme; dhe

b) Të dyja palët duhet të lehtësojnë dhe përshpejtojnë kërkesat për autorizimet e punësimit të personelit i cili kryen detyra të caktuara të përkohshme pa kaluar 90 (nëntëdhjetë) ditë.

Neni 17

Shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet aeronautike të të dyja Palëve sipas kërkesës, duhet të shkëmbejnë informacion sa më shpejt të jetë e mundur, në lidhje me autorizimet aktuale të lëshuara Linjave Ajrore të Përcaktuara respektive për të kryer shërbim në, përmes dhe nga Territori i Palës tjetër. Kjo do të përfshijë kopje të certifikatave dhe autorizimeve aktuale për shërbime në itineraret e propozuara, së bashku me amendamentet ose urdhrat përjashtuese.

2. Autoritetet aeronautike të secilës Palë do të detyrojnë linjën/linjat ajrore të përcaktuara të tyre, t'i japin autoriteteve aeronautike të Palës tjetër, sipas kërkesës, deklarata periodike ose të tjera të statistikave siç mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme.

Neni 18

Miratimi i orareve

1. Linja ajrore e secilës Palë do të paraqesë për miratim tek autoritetet aeronautike të Palës tjetër oraret e fluturimeve të tij të parashikuar, të paktën 30 (tridhjetë) ditë para operimit të shërbimeve të miratuara. E njëjta procedure do të zbatohet për çdo modifikim të tyre.

2. Për fluturimet plotësuese në të cilat linjat ajrore të përcaktuara të një Pale dëshirojnë të operojnë shërbimet e miratuara jashtë orareve të përcaktuara, ajo linjë ajrore duhet të kërkojë leje paraprake nga autoritetet aeronautike të Palës tjetër. Kërkesa të tilla zakonisht do të paraqiten të paktën 5 (pesë) ditë pune përpara operimit të fluturimeve të tilla.

Neni 19

Shtojca

Shtojca e kësaj Marrëveshje konsiderohet një pjesë integrale e saj.

Neni 20

Konsultime

1. Secila Palë mund, në çdo kohë, të kërkojë konsultime mbi interpretimin, zbatimin, implementimin apo amendimin e kësaj Marrëveshje ose në përputhje më këtë Marrëveshje.

2. Konsultime të tilla, të cilat mund të zhvillohen nëpërmjet diskutimeve apo korrespondencës, duhet të fillojnë brenda një periudhe prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh që nga data e marres së kërkesës me shkrim nga Pala tjetër, përveç rasteve kur Palët bien dakord ndryshe.

Neni 21

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Për çdo mosmarrëveshje që lind midis Palëve në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj Marrëveshje, përveç atyre që mund të lindin sipas nenit 7 ("Siguria") dhe nenit 8 ("Sigurimi i Aviacionit"), autoritetet aeronautike të të dyja Palëve në radhë të parë do të përpiqen ta zgjidhin atë nëpërmjet konsultimeve dhe bisedimeve.

2. Nëse Palët dështojnë në arritjen e një zgjidhje nëpërmjet bisedimeve, mosmarrëveshja do të zgjidhet përmes kanaleve diplomatike.

Neni 22

Amendamentet

Çdo amendament i kësaj Marrëveshje miratuar nga të dyja Palët, do të hyjë në fuqi në një datë që do të përcaktohet nga shkëmbimi i notave diplomatike, duke treguar kështu se të gjitha procedurat e brendshme të nevojshme janë plotësuar nga të dyja Palët.

Neni 23

Marrëveshjet shumëpalëshe

Nëse një marrëveshje shumëpalëshe për transportin ajror hyn në fuqi për të dyja Palët, Marrëveshja aktuale do të amendohet në mënyrë që të jetë konform dispozitave të asaj marrëveshje shumëpalëshe.

Neni 24

Përfundimi

Secila Pale, në çdo kohë, mund t'i njoftojë me shkrim, përmes kanaleve diplomatike, Palës tjetër vendimin e saj për të përfunduar këtë Marrëveshje. Ky njoftim duhet t'i komunikohet menjëherë ONAC-ut. Kjo Marrëveshje do të përfundojë në mesnatën, me orën lokale të Palës së njoftuar, menjëherë para përvjetorit të parë të datës së marrjes së njoftimit nga Pala tjetër, përveç rastit kur njoftimi tërhiqet me marrëveshje përpara përfundimit të kësaj periudhe. Në mungesë të njohjes së marrjes nga Pala tjetër, njoftimi do të gjykohet se është marrë 14 (katërmbëdhjetë) ditë pas marrjes së njoftimit nga ONAC-u.

Neni 25

Regjistrimi me ONAC-un

Kjo Marrëveshje dhe çdo amendament në të do të regjistrohet me nënshkrimin e saj me ONAC-un nga Pala në territorin e të cilës është nënshkruar kjo Marrëveshje.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së notës së dytë diplomatike, i cili tregon se të gjitha procedurat e brendshme të nevojshme janë plotësuar nga të dyja Palët.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, të autorizuar sipas rregullit nga qeveritë e tyre respektive, kanë nënshkruar Marrëveshjen aktuale.

Bërë në Brazilia, këtë të 4-t, ditë të nëntorit, në dy kopje, në gjuhët shqipe, portugeze dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë autentike. Në rast të çdo mospërputhje në interpretimin e teksteve në shqip dhe portugalisht, teksti anglisht do të mbizotërojë.

SHTOJCË

PROGRAMI I ITINERARIT

Seksioni 1

Internetet e zbatuara nga linja/t ajrore të përcaktuara të Republikës së Shqipërisë

Nga	Pika të ndërmjetme	Për	Përtej pikave
Çdo pikë në Republikën e Shqipërisë	Çdo pikë	Çdo pikë në Brazil	Çdo pikë

Seksioni 2

Internetet e zbatuara nga linja/t ajrore të përcaktuara të Republikës Federative të Brazilit

Nga	Pika të ndërmjetme	Për	Përtej pikave
Çdo pikë në Brazil	Çdo pikë	Çdo pikë në Republikën e Shqipërisë	Çdo pikë

Operimi i shërbimeve të miratuara:

1. Linja/t ajrore të përcaktuara të të dyja Palëve, mund, për çdo ose të gjitha fluturimet dhe me zgjedhje të saj, të operojë në njërën apo në të dyja drejtimet; të shërbejë në pika të ndërmjetme ose të përtejme në itineraret në çfarëdolloj kombinimi dhe çfarëdolloj rendi; të heqë thirrjet në çdo apo të gjitha pikat e ndërmjetme apo të përtejme; të ndërpresë shërbimet në territorin e Palës tjetër dhe/ose në ndonjë pikë përtej këtij territori; të shërbejë në pika brenda territorit të secilës Palë në çdo lloj kombinimi pa të drejta kabotazhi; të transferojë trafikun nga çdo avion i përdorur prej tyre kundrejt çdo avioni tjetër në çdo pikë/pika të itinerarit; të kombinojë numra të ndryshëm fluturimi brenda operimit të një avioni; të përdorë avionë në pronësi të tij apo të marrë me qira.

2. Linja/t ajrore të përcaktuara të të dyja Palëve kanë të drejtë të ushtrojnë, në çdo lloj shërbimi (pasagjerë, ngarkesë, të ndarë apo të kombinuar), pesë të drejtat e plota të lirisë së trafikut për/nga çdo pikë ndërmjetëse ose të përtejme pa asnjë lloj kufizimi.